

ELIDA BEGAJ

TOTEMI I BUELLIT NË POEZINË E CAMAJT

Hyrje. 1.0

Totemit të Buellit i jep emrin një cikli të plotë me poezi të Martin Camajt. Qëllimi i këtij punimi është rikrijimi i këtij cikli si një udhëtim Camaj- lexues, si një lexim që përfron simbolikën e “buellit” përtej leximit të sipërfaqshëm, duke u nisur nga kuptimi biologjik, nocioni gjuhësor e deri tek përfronia e simbolikës së tij me mitologjinë e indianëve të Amerikës së Veriut. Në punim, fjala “bual” është shkruar edhe në dialekt, “buelli”, kur është e cituar nga poezitë apo nga interpretimet e ndryshme. Si motiv i këtij punimi është interpretimi i Anton Berishës rreth poezisë e Camajt. Ai është “i bindur se bota e legjendave dhe gojëdhanave, gërshetuar me mite, ofronte mundësi të mëdha trajtimi artistik¹”.

1.1. Buelli dhe shumëkuptimësia e tij.

Totemi i Buellit i jep emrin një cikli të plotë me poezi të Camajt. Ai rrëfen se ka disa rrethana të jetës që njeriu don me i harrue por shënjon që në krye të ciklit, baltën, ujin, votrën, zjarmin dhe Arbëninë. Trungu i çdo poezie në këtë cikël e mbart, shenjën e “Buellit”. Veçojmë “Kau dhe Buelli”. Në poezinë “Buell, emën mali”, në një varg e sjell buellin “lugat”, aty këtu “buelli çon kryet në rrëkajë e qit jashtë vapën, gjinie femnore”. Te poezia “Rapsodi në letër” dhe “S’ dihet se kah erdhi” të grish me prejardhjen e buejve citoj: “De Rada pau si hypën buejt nga Sibari”; “S’ dihet se ka erdhi ai buell anës së lumit tue pallë”. Madje, Camaj zgjedh të rrëfejë në vetën e parë, citoj: ‘nuk due me pa’ si mbytet një buell i lindun në këtë shekull’. Dalëngadalë në vargje lexojmë fundin e kafshës, ‘buelli dridhi kryet’ madje, ai nuk heziton të identifikojë edhe emrin e atij i që e theri, ‘Ai që i thonë Me’ksh e theri buellin e ri’. Në vargjet e fundit të ciklit ‘ ishte një buell i egër’ dhe rrufeja në vargjet e fundit nuk fal as Buellin” por askush s’ hëngri mishin e vramë rrufeje në Qytetin e Ri e askund².

¹ A. N. Berisha (2010), *Vepra Letrare e Martin Camajt*. Botimet Princi.

² M. Camaj (2010), *Palimpsest*, Onufri. Vargjet janë huazuar nga cikli “Buelli” nga f. 59, 67, 68, 72, 73, 75, 78.

“Krijimi, nuk është si të ndërtosh një ushtrim as një qytet por, vetë Universin, ku lidhja detaj- dinamikë sjell krijimin”. Ndërsa Barthes pretendon, se ‘detyra e shkrimtarit’ nëse ai do të kishte të tillë, do t’i duhej të kthente lexuesin jo në konsumator të thjeshtë por në një krijues të tekstit”³.

Nëse do të rikrijonim ciklin “Buelli”, a do ta konsideronim një rrugëtim Camaj- lexues? Camaj i hap dritën jeshile kësaj pyetjeje. “Nuk duhet të ngatërrojme pjesën aksiomatike që lidhet me leximin sipërfaqshëm që mund ta çojë lexuesin deri te përfundimi krejt tjetërsues se ka ndër duar një shkrim biologjik”. Sa ndryshon koncepti i ‘Buellit’ nga biologjia në mitologji? Po në besim? Sa i herët është ky nocion në gjuhë shqipe? A mbart shumëkuptimësi si korbi edhe buelli?

Enciklopedia e përkufizon buallin si: Bualli ang (buffalo). Pjesëtar i familjes së GJEDHIT, Bovidae. Ka dy lloje të veçantë, bualli i ujit i Azisë, *Bubalus arnee (bubalis)*, dhe bualli afrikan, *Syncerus caffer*. Buajt e kanë ballin të rrumbullakosur, brirët u anohen dhe përkulen shumë përpara, para se të përdridhen për lart, si dhe kanë veshë të mëdhenj. Qimja e shkurtër ua lë pothuaj të zhveshur lëkurën. Lëkurën e kanë të zezë, ndonjëherë pak në kafe. Që të gjithë zhgërryhen në baltë; kjo i mbron nga këpushat dhe insektet e tjera. Buajt e Afrikës gjenden në gjithë Afrikën; nënloji më i madh është bualli i Kepit, i cili është i afër 2.75 m i gjatë. Është bartës i parazitit të gjakut që shkakton sëmundjen e gjumit të njeriut dhe mbartet prej mizës cece. Ndonëse ishte i rrezikshëm, është zbutur më vonë dhe përdoret si kafshë tërheqëse.⁴

Fjalori i Gjuhës Shqipe rendit tri kuptime të fjalës, BUALL.

1-BUALL. *m.sh.* kafshë shtëpiake ripërtpëse e dythundrake, me trup të madh e të mbuluar me qime të zeza, me qafë të shkurtër dhe me brirë të kthyer prapa që mbahet për punë bujqësore. *I rëndë, (i ngathët) si buall. 2-fig. të keqe.* Burrë me trup të madh e të rëndë, por i ngathët i trashë nga mendja. 3. Kacadre.⁵

Fjala “buall” shënon që prej 1333, Dhimitër S. Shuteriqi në leksikon “Dëshmi Parabuzukjane të Fjalës Shqipe”, fjalën ‘buall’ e lidh me shpjegimin e ‘Bua’ – “Bua. m, shm. Buajt – Fis feudal shqiptar i Jugut dhe

³ M. Corti, *Parime të komunikimit letrar*, f. 3.

⁴ Instituti i dialogut dhe i komunikimit (2006), *Enciklopedia e Përgjithshme e Oksfordit*, Tiranë, f. 192.

⁵ Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë Tiranë (1984), *Fjalori i shqipes së sotme*, f. 113.

i GR, edhe Bua Spata, Shpata 1333 M (greqisht) popullsi shqiptare e vendosur në Thesali sipas Kanatakuzenit (BH II160)⁶.

Po këtë fjalë, por në gjininë femërore e gjejmë dhe në studimin “Fjalori i Shqipes së Gjon Buzukut”. Buollic/ë, -a. f. (*rrjedh*, buollicashit) buallicë. Përdoret vetëm një herë: n’deshshit e n’buollicashit (XXVI/2)⁷. Camaj e rikuperon në formën toske të toponimit mesjetar himariot Bua, në një nga argumentet që përdoret prej Çabejt për shpjegimin e etimologjisë së rrënjës së hipotezuar indoeuropiane, që gjendet në fjalën paragreke “boli”, “bula” - dem. Jeta e fjalës antike gjallon nëpër “korpët” e gjuhëve të ndryshme, duke marrë trajta “shkrolash”/arabeskash, të cilat “burgosin” në forma gjithfarësh të njëjtin kumt, të cilin ia përcjell dhe fjalës poetike të poetit në gjuhën shqipe⁸.

“Buelli” lidhet me mitin e lashtë të këtij frymori në vise të Mesdheut si zot i fushave, por edhe me procesin e shfarosjes së tij gjatë brigjeve të Lugut të Drinit e më larg. Shpresoj së lexuesit vetë do ta zbulojnë domethanien e këtij cikli poezish që simbas përkthyesve e gjykuesve na qenka mjaft i vështirë⁹ Simbolika e “buellit” e cila degëzohet në disa drejtime dhe shtrihet në disa rrafshë. Këtë degëzim dhe këtë shtrirje e bën të mundur para së gjithash përmasa mitike, që e përshkon ciklin fillim e mbarim. Mitikja këtu nuk është aprioristike, as gjithëzotëruese¹⁰. Gjuhën e cilëson shkallë e lartë e shumësisë shprehësore, e simbolikës dhe e abstraksionit; ndërlidhja e brendshme e rrafshëve kuptimore – me ç’rast bëhen prerje diakronike dhe sinkronike të botës dhe të jetës shqiptare – është e ndërliqshme dhe me mundësi të shumta konotuese¹¹.

Modeli i krijimtarisë popullore i rimarrë në letërsinë e shkruar në një pikë më të largët ka prekur ligjërimin letrar duke e shpënë kah ligjërimin legjendar. Legjenda dhe hiperbola sikur bëhen shenja dalluese jo vetëm të literaturës por edhe të kulturës shqipe. Problemet sociale dhe nacionale madje dhe politike nuk kanë mundur të mos e përshkruajnë letërsinë nga

⁶ Dh. S. Shuteriqi (2010), *Dëshmi parabuzukiane të fjalës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, f. 29.

⁷ Th. Qendro (2013), *Fjalori i Shqipes së Gjon Buzukut*, Shoqëria Biblike Ndërkonfesionale e Shqipërisë, Tiranë, f. 50.

⁸ B. Suta (2012), *Rikthimi i fjalës së Camajt*. Palimpsest, Camaj. Shtëpia Onufri, Tiranë, f. 12.

⁹ M. Camaj, “*Individualiteti ynë shprehet në letërsinë dhe arti tonë*”, Nëntori, nr. 4, f. 119.

¹⁰ A. N. Berisha (2010), *Vepra Letrare e Martin Camajt*. Botimet Princi, f. 63.

¹¹ Po aty, f. 60.

tematikat e deri te struktura. Letërsia shqipe është ndikuar shumë herë nga subjektet madje dhe nga mënyrën e strukturimit më të thellë letrar prej krijimtarisë gojore. Kjo ngjet edhe pse në shqip krijimtaria gojore në gjithë shekullin e kaluar ishte e gjallë dhe produktive përballë letërsisë së shkruar.

1.2. Simbolika e Buallit, përtej mitologjisë dhe folklorit evropian

Besime të ndryshme e përshkruajnë buallin, si një kafshë të egër e të përgjumur apo, e mbarsin me një kuptim të ri?

Një prej tyre është besimi Sioux që është një emër i përbashkët për shtatë grupe tribale të cilët janë organizuar në tri bashkësi të mëdha politike. Për herë të parë me këtë term u regjistruan në vitin 1640 nga Jean Nicolet në Jezuit Relation. Dy eksplorues francezë në vitin 1660 Radisson dhe Chouart e hasën në lindje, ku është sot Minnesota në SHBA. Religjioni Sioux e ndërton simbolikën mbi kafshën e buallit, i cili mbart simbolikën thelbësore në jetën e tyre. Ai ishte shok i Diellit, kontrollonte të gjitha çështjet e dashurisë, kujdesej për familjen, shëndetin, të rinjtë, dhe për mbarësinë në të mbjella. Simbolika e buallit ishte në qendër të jetës dhe mendimit dhe ishte shumë shkatërruese ideja e asgjësimit të kësaj simbolike për këtë kulturë dhe traditat që ajo mbarte. Simbolika shtrihet në paraqitjen e Universit në katër drejtime, sepse ai qëndron në katër këmbë. Secila prej këmbëve përfaqësonte katër moshat e njeriut. Në formimin e botës Wakan – Tanka e kishte vendosur buallin në përfundim. Ishte kuptimplotë vendosja, për të mbajtur prapa ujërat. Çdo vit, ai (bualli) humbet flokët dhe në çdo një nga katër moshat e tij, humb këmbët. E gjitha do të përfundojë kur të gjithë flokët dhe këmbët e buallit të jenë zhdukur dhe uji të kthehet e të mbulojë tokën. Sipas tyre, lloji njerëzor ka dalë nga barku i mëmës tokë ashtu si bualli¹².

Në ciklin “Buelli” Camaj, jo vetëm që nuk identifikohet me origjinën e botës, por vargjet e poezisë “I biri i dekës” sjellin krejt të kundërtën e këtij besimi. Ai nuk dihet nga vjen dhe janë njerëzit që kanë në dorë fatin e tij. Buelli nuk ndihet Zot, por i pambrojtur. Citoj:

“si e lidhën me krye për lis

buelli priti e priti kur po i binte tuni i sëpatës në ballë”

Është krejt e kundërta. Buelli kërkon mbrojtje, kërkon gurin, vatrën, ndoshta fisin e largët, por rrugëtimi i tij përfundon në duart e Mekshit.

“Ai që i thonë Meksh

¹² <http://www.philtar.ac.uk/encyclopedia/nam/sioux.html>

e theri buellin e ri”

Folklori i Indianëve të Amerikës e lidh fatin e buallit dhe korbit në rrëfenja dhe legjenda. Dikur, bualli ishte ushqimi kryesor për fiset indiane. Pamundësia e mjeteve të gjuetisë, armëve i drejtonte te ritet e shumta e lutjet. Të shumta ishin historitë e gjuetisë të cilat vijnë tek ne sot në formën e gojëdhënave e legjendave. Dy prej tyre, të rrëfyera në Legjendat e Indianëve të Amerikës, e ilustronjë më së miri:

- *“Kur toka dhe njerëzit ishin ende të rinj, edhe korbat ishin të bardha si bora. Ato kohë të hershme, njerëzit nuk kishin as kuaj, as mjete për zjarr, as pushkë të hekurta. Jeta e tyre varej nga gjuetia dhe ushqimi i buellit. Një buall i madh ishte i vështirë, shumë i rrezikshëm të gjuhej me armë guri. Korbat e bënë akoma dhe më të vështirë për gjuetarët sepse ato, ishin miq me buajt. Fluturuese në lartësi të mëdha, ato, mund të shihnin gjithçka. Kudo që ndodheshin i shihni gjuetarët ,që organizoheshin dhe fluturonin tek miqtë e tyre, uleshin mes brirëve dhe i lajmëronin ‘Caw, caw, caw!’ Kushërinj, gjuetarët po vijnë”. Janë maskuar dhe po zvarriten nëpër shtigje. Janë duke ardhur, mbrapa kodrave, kujdes! “Caw, caw, caw!” Sapo dëgjonin këtë, buajt largoheshin në rrëmujë dhe njerëzit mbeteshin përsëri të uritur. Kështu, ata u mbledhën në një këshill dhe vendosën si do të vepronin. Në tufën e paralajmëruesve ishte dhe një korb dy herë më i madh se të tjerët. Ai ishte kryetari. Një plak i ditur, tha. Ne duhet të kapim korbin e madh të bardhë, dhe t’i japim atij një mësim, ndryshe do mbesim gjithmonë të uritur. Ai nxori një lëkurë të madhe bualli të pa hequr kokën dhe brirët, dhe ia hodhi në shpatulla një djaloshi. Nipçe, futu mes buajve, ata do të mendojnë se je një prej tyre, dhe kështu do të zësh korbin e madh të bardhë. Maskuar si buall, djaloshi u fut mes tufës filloi të bënte dhe sikur kulloste. Më i madhi i buajve, nuk i kushtoi kujdes. Gjuetarët i ndoqën pas duke i mbajtur harqet gati. Kur ata iu afruan tufës, korbat fluturuan si gjithmonë të paralajmëronin buajt. ‘Caw, caw, caw, kushurinj!’ Gjuetarët po vijnë t’u vrasin, kujdes nga harqet e tyre, ‘Caw, Caw, caw!’ Dhe, si gjithmonë turma u largua me të shpejt përveç, gjuetarit të ri të maskuar që vazhdonte ende të ushqej. Atëherë, korbi i madh fluturoi poshtë në shpatullat e djaloshit, përplasi krahët dhe i tha ‘Caw, Caw, caw!’ Vëlla, je gjë shurdh? Gjuetarët janë pranë mbi kodër. Shpëto veten! Por, gjuetari i ri e kishte arritur. E kapi prej këmbësh dhe ia lidhi shpejt tek një gur i rëndë. Sado që luftoi, ishte pamundur të shpëtonte. Këshilli u mbledh përsëri dhe ata duhet të vendosnin, çfarë te bënin? Njëri nga gjuetarët mendoi ta digjte dhe asnjë nuk do ta ndalonte, dhe pa prituri përgjigje, ai e rrëmbeu nga duart e hodhi në zjarr. Zogu u*

*përpoq të shpëtonte por i lidhur te guri, një pjesë e mirë e pendëve iu dogjën. Tani ishte i madh, por jo i bardhë. Ai qante dhe shpejtoi të largohej që andej, sa më shpejt të mundej. 'Caw, caw, caw! Nuk do ta përsëris më, nuk do të lajmëroj më buajt. Si unë, dhe e gjithë tufa e korbave. Kështu, ai u largua por që atëherë, ata mbeten të zinj.'*¹³

Ndërsa 'Vëlla korbi dhe vëlla bualli' është motërzim i rrëfenjës së parë, por mesazhin e vendos tek besnikëria. Rrëfenja fillon pothuajse njësoj:

*"Korbi ishte bardhë në fillim. Ai ishte vëlla i buallit. Shawne, ja kishte nevojën buallit për ushqim dhe lëkurë por e kishte të pamundur se korbi e lajmëronte. Rreth zjarrit, gjatë festimeve para gjuetisë Cawanemua tha: "Ne duhet të bëjmë diçka. Unë do të vesh lëkurën e buallit dhe do të kërkoj bar. Kur korbi të vij ta lajmëroj unë do ta zë". Ditën tjetër, ata u organizuan dhe vepruan. Korbi erdhi ta paralajmëronte buallin. Cawanemau u hodh, e kapi dhe e mori me vete në kamp. Në darkë, rreth zjarrit kur po diskutonin fatin e korbit, Panseau, luftëtari më i ri dhe më trimi shihte dhe dëgjonte korbin. Kishte shumë mendime, disa donin ta ndëshkonin sepse i kishte lënë pa ngrënë. Disa mendonin ta linin të lirë. Cawanemaw ishte më gjaknxehtë se të tjerët. E rrembeu dhe e hodhi në flakë. Panseau e shihte si digjej dhe e nxorri nga zjarri. Cawanemaw u tërbua me Panseaut. Korbi na mashtron, ne jemi të uritur dhe kemi ftohtë sepse ai lajmëron buallin. Tani e shpëton dhe nga flakët. Panseau me zë të ulët foli, "korbi lajmëroi vëllanë e tij siç do të bëja dhe unë për ty, vëlla. Korbi dëgjoj Panseaut dhe foli. "Unë, tani jam i zi sepse lajmërova vëllain tim tani dhe Panseau është vëllai im."*¹⁴ Aspekti i zbulimit të shpirtit e preokupon vazhdimisht autorin. Me kompleksitetin e jetës, në marrëdhëniet me natyrë – njeri – shoqëri, jo rastësisht, zbulon të vërteta mjaft domethënëse që lidhen me portrete të natyrave të ndryshme ku zbulohet fisnikëria e shpirtit, gjë që e preokupon dukshëm edhe në krijimet e vona¹⁵. Folklori duket sikur i ka kaluar kufijtë gjeografikë. Korbi dhe Buelli duket sikur janë huazuar nga legjendat shqiptare, nga korbi i shkruar në poezinë "Korbi" tek i paqti korb te "Një ditë e ka dhe korbi". Kjo ngjet edhe pse në shqip krijimtaria gojore në gjithë shekullin e kaluar ishte e gjallë dhe produktive përballë letërsisë së shkruar.

¹³ www. Native American Indian Legends Folklore.com. *Haw the Crow came to be black.*

¹⁴ Po aty. Native American Buffalo Mythology. *The Buffalo Legend*

¹⁵ Kalamitri. E(1993) *Subjekti poetik dhe lirizmi*. Martin Camaj tradita dhe bashkëkohësia. f. 63

I rikthehemi fati të Buellit. “Vëllai Korb dhe vëllai Buall”, edhe pse me prejardhje të ndryshme, janë të pandarë. Korbi i legjendës dhe korbi i Camajt kanë të përbashkët paqen “*e ndjeu vehten korbi pllumb në shpirt*” shkruan Camaj. E korbi, nuk ka vëlla vetëm buallin por dhe njeriun, edhe pse ai i ndryshoi fatin.

I rikthehemi edhe njëherë ciklit “Buelli”. Krijimi i fundit është i këtij cikli titullohet “Qytet i ri” i cili, ngrihet mbi rrënojat e qytetit të vjetër.

Ku vrau, ku s’vrau?

Buellin tim e mori bri në bri

Kokrra e zjarmit nën mriç.

Erdhi era tym lëkure së djegun

E shkrum ashti ndër gur.

*Dhe askush se hëngri mishin e vramë rrufeje në Qytetin e Ri
e askund*

Nisur prej këtyre vargjeve vëmë re se Camaj ka ecur në kohë dhe ka gjetur origjinën e vërtetë të sakrifikimit, mit, i cili vjen nga Azia Perëndimore, ku rrëfëhet, se bota lind nga vdekja, dhe gjithçka e re simbolizon fortësinë dhe pavdekshmërinë, pasi trojet janë larë në gjak. Gjithçka e fortë, e bukur lind nga një sakrificë e madhe. Bota lindi nga sakrificat të qenieve nga më të larmishme si Breshka, Dranja, Buelli e Korbi, si pjesë e saj nuk mund të mënjanoreshin nga kjo sakrificë. Camaj është pjesë e këtij flijimi, natyrisht jo fizik por shpirtëror. Në kthim, buelli drejtohet tek zjarri që djeg në vatër e në fund, një qytet që shkrumbohet nga zjarri. Kur diçka shkrumbohet ngacmon dy ndjesi. Keqardhjen, s’do shohësh më atë çfarë ka ekzistuar dhe e dyta, kënaqësinë e rindërtimit. Zjarri, në këtë cikël përveç shkatërrimit mbart dhe ndjesinë e rifillimit të diçkaje apo gjithçkaje prej hirit, pra, nga ajo çfarë ka mbijetuar në kujtesë, aq sa është e mjaftueshme për të identifikuar Camajn me origjinën e tij.

BIBLIOGRAFI

Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë Tiranë (1984),

Fjalori i shqipes së sotme. f. 113.

Berisha, A. (2010), *Vepra Letrare e Martin Camajt*. Botimet Princi. f. 63.

Camaj, M. (2010), *Palimpsest*, Onufri “Buelli” nga f. 59, 67, 68, 72, 73, 75, 78.

Camaj, M. Cituar nga intervista “*Individualiteti ynë shprehet në letërsinë dhe arti tonë*” Nëntori, n. 4, f. 119.

Corti, M., *Parime të komunikimit letrar*”, f. 3.

- Enciklopedia e Përgjithshme e Oksfordit (2006), *Instituti i dialogut dhe i komunikimit.*, f. 192.
- [http:// www. Native American Indian Legends Folklore.com](http://www.NativeAmericanIndianLegendsFolklore.com) Haw the Crow came to be black.
- [http://www. Native American Indian Legends Folklore.com](http://www.NativeAmericanIndianLegendsFolklore.com). Buffalo Mythology. *The Buffalo Legend* Native American Indian Legends Folklore.com
- <http://www.philtar.ac.uk/encyclopedia/nam/sioux.html>
- Kalamitri, E. (1993), *Subjekti poetik dhe lirizmi*. Martin Camaj tradita dhe bashkëkohësia. f. 63.
- Qendro, Th. (2013), *Fjalor i Shqipes së Gjon Buzukut*, Shoqëria Biblike Ndërkonfesionale e Shqipërisë, Tiranë, f. 50.
- Suta, B. (2012), *Rikthimi i fjalës së Camajt*. Palimpsest, Camaj. Shtëpia Onufri, Tiranë, f. 12.
- Shuteriqi, Dh. S. (2010), *Dëshmi parabuzukiane të fjalës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, f. 29.